



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

---

Numri i lëndës: 2018:063438

Datë: 06.03.2020

Numri i dokumentit: 00881701

Numri i lëndës: 2018:014326

Datë: 13.06.2018

Numri i dokumentit: 00060583

**P nr.1014/16**

## NË EMËR TË POPULLIT

### GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni

**Penal**,si gjykatë e shkallës së parë penale,me gjyqtarin individual Elmaz Zenuni dhe me sekretaren juridike Igballe Arifi, në lëndën penale kundër të akuzuarit S.K, nga fshati ... Komuna e Ferizajt, për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 358 par. 2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II Nr.1113-6/2016 të dt. 21.10.2016, në shqyrtimin e kryesor të hapur gjyqësor të mbajtur me datën 06.03.2020, në praninë e Prokurorit të shtetit Valdet Avdiu, të akuzuarit, mori dhe publikisht shpalli, kurse me dt.06.03.2020, me shkrim përpiloi këtë:

## AKTGJYKIM

**I akuzuari, S.K**, nga fshati ... Komuna e Ferizajt , i lindur me ....., në të njejtin vend, nga i ati Z..... dhe e ëma B.... e gjinisë Q....., i pa punë, ka të kryer shkollën fillore, i martuar baba i 1(një) fëmie, i gjendjes së varfër ekonomike, me nr.personal, .....,shqitpar, shtetas i Kosovës,

## ËSHTË FAJTOR

Sepse me datën 20.06.2016 rreth orës 10,20 në pyllin publik të cilin e menaxhon Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural-zyra në Ferizaj, në Rajonin Eonomiko-PyJOR në fshatin Neredime-Jezerc në vendin e quajtur “V.V” me qëllim vjedhjeje me sharrë motorike ka prerë 1 copë dru ahu të njomë, me diametër 80 cm., në vëllim 6.05 m3, të cilat i ka bartur me traktor Rakovica dhe në vlerë të dëmit prej 816.75 €.

**me të cilën ka kryer veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par.2 të KPRK-së.**

Gjykata, në kuptim të nenit 358 par.2 të KPRK-së, dhe nenit 3,11, 17, 46, 47, 51 dhe 73 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së, e

## G J Y K O N

Me dënim në të holla në shumë prej 300 /treqind / Euro, të cilat është i obliguar që ti paguaj në afatin prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyrat tjera të parapara nga nenin 46 par.3 të KPRK-së, gjykata do ta ekzekutoj akgjykimin në atë mënyrë që të pandehurit për çdo 20 € të gjobës të vuaj në një ditë burgu.

*Njëkohësisht*, të akuzuarit i shqiptohet denimi me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) mujave burgim, i cili denim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 1 (një) viti nuk kryen vepër tjetër penale.

Obligohet i pandehuri që të damtuarit- DBPZHR- zyra në Ferizaj në emër të kërkesës pasuroro-juridike të i bëjë kompensimin e dëmit në lartësi prej 816.75 €.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqsor të paguaj kësaj gjykate shumë prej 20 /njëzetë/ Euro, në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së katgjykimit nën kërcnimin e ekzekutimit me dhunë.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohet i akuzuari që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

## Arsyetimi

Prokuroria Themelore në Ferizaj ka ushtruar aktakuzën e vet PP/II Nr.1113-6/2016 të dt. 21.10.2016, kundër të akuzuarit S.K, nga fshati ... komuna e Ferizajt, për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 358 par.2 të KPRK-së.

Gjykata, duke vepruar sipas akuzës së PTH-së në Ferizaj më datën 06.06.2019 ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor në të cilën Prokurori i shtetit Valdet Avdiu si në fjalën hyrëse, por edhe ate përfundimtare deklaroj: se ngel në tërësi pranë aktakuzës dhe kualifikimit juridik të veprës penale, i propozoj gjykatës që të nxjerrë provat e propozuara në aktakuzë, dhe pas vlersimit të tyre i akuzuari të shpallet fajtor dhe të i shqitpohet dënimi i parapar me ligj.

I akuzuari në shqyrtimin gjyqësor delaraj: se e ndin vehtën fajtor për veprën penale e cila i veket në barrë, pra për veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par.2 të KPRK-së dhe shton se kurr njëherë nuk do të shkoj në pyll në të ardhmen.

Përfaqësuesi juridik i të dëmtuarës DBPZHR- zyra në Ferizaj nuk ishte i pranishëm në shqyrtim gjyqësor edhe pse Ftesën e gjykatës e ka pranuar,por nuk është paraqitur në shqyrtim gjyqësor.

Në vlerësimin e pranimin të fajësisë së të pandehurit gjyqtari gjykues konform nenit 248 par.2 dhe nenit 326 të KPPRK-së, ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit përkitazi me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, ashtu që prokurori i shtetit është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Gjyqtari gjykues ka vlerësuar se kërkesat nga neni 248 paragrafi 1 dhe nenit 326 i KPPRK-së janë përmbushur, pasi që:

- I pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë,

- Pranimi është bërë vullnetarisht ,
- Pranimi mbështetet në prova dhe fakte të çështjes penale që përmban aktakuza dhe materialet e prezentuara nga ana e prokurorit të shtetit me aktakuzë dhe ate: vlerësimi dhe llogaritja e dëmit të pyllit nga fletëparaqitja për dëmtimin e pyllit e Drejtorisë për Bujqësi, Pyllitari dhe Zhvillim Rural, zyra në Ferizaj si dhe procesverbali me nr. 164/2017, numër protokolli 164/17 i dt. 29.08.2017, dhe Procesverbali i dëmit të shkaktuar me numër dhe datë të njejtë,
- akuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore ose gabime faktike, njashtu i akuzuari është udhëzuar nga ana e gjyqtarit gjykues edhe konform nenit 383 par.2 të KPPRK-së, përkitazi me të drejtën e ankesës vetëm për sanksionin penal, por jo edhe për shkak të gjendjes faktike, si dhe
- Konform nenit 257 të KPPRK-së, aktakuza nuk ka prova të pa pranuesheme.

Gjatë shqiptimit të dënimit në kuptim të nenit 73 të KPRK-së gjykata pati parasysh rrethanat lehtësuese dhe randuese, si rrethana lehtësuese gjykata pati parasysh faktin se i akuzuari është pa punë dhe pa të ardhura, i martuar dhe ka fëmijë dhe i gjendjes së varfër ekonomike.

Si rrethana tjera rënduese gjykata pati parasysh shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës së kryer, e sidomos dëmin e shkaktuar.

Ndërsa, rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti. Gjykata të pandehurit i shqiptoj një dënim me gjobë duke marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale duke i caktuar dënim me gjobë të paraparë me neniin 46 par.4 të KPRK-së.

Njëkohësisht, të akuzuarit i shqiptohet denimi me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) mujave burgim, i cili dënim konform nenit 51 të KPRK-së nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 1 (një) viti nuk kryen vepër tjetër penale. Kështu, me denimet e shqiptuara do të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale dhe asaj gjenerale i paraparë me nenit 41 të KPRK-së.

Konform nenit 458-463 të KPPRK-së obligohet i akuzuari që DBPZHR-Zrya në Ferizaj në emër të kërkesës pasuroro – juridike të i kopmensoj dëmin e shkaktuar në shumën prej 819.75 €.

Konform nenit 454 par.1 të KPPRK-së i akuzuari obligohet në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqsor të paguaj kësaj gjykate shumënprej 20 /njëzet/ Euro,në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së katgjykimit nën kërcnimin e ekzekutimit me dhunë.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohet i akuzuari që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Nga arsyet e sipërcekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,  
P.nr.1014/16 të dt. 06.03.2020.**

**Sekretare juridike,  
Igballe Arifi**

**Gj y q t a r i  
Elmaz Zenuni**

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 dite, Gjykatës së Apelit në Prishtinë.  
Ankesa dorzohet nëpërmes kësaj gjykate.